
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Procesverbal
Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Dimal
Mbajtur më date 22.11.2023

Ora e hapjes së mbledhjes 13:00, vendi i mbajtjes së mbledhjes në Njësinë Administrative Poshnje kati i I-rë salla e mbledhjeve e Këshillit të Bashkisë Dimal. Mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë Dimal e hapur.

Listë prezenca e këshilltarëve pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes.

1. Adelina Vangjeli
2. Avdulla Salillari
3. Ardit Tafa
4. Bajame Mjelli
5. Bajame Zyka
6. Bukuroshe Goga
7. Gramoz Hazizolli
8. Hysen Hoxha
9. Julian Kora
10. Kozeta Protoduari
11. Lorenc Plaku
12. Luto Goga
13. Petref Sula
14. Petro Tumani
15. Razije Baho
16. Saljon Hoxha
17. Shkelqim Tafa

U deklarua korumi prej 17 Këshilltarësh

Në mbledhje janë të pranishëm përfaqësues të administratës të cilët kanë hartuar projekt vendimet që do të merren në shqyrtim.

Kryetari i Këshillit deklaroj hapjen e mbledhje.

Pika 1 e rendit të ditës: Miratimi i rendit të ditës.

Sh.Tafa: Kam dicka në lidhje me rendin e ditës, materiali i sjellë për “Qytetar Nderi”, pika 8 e rendit të ditës për mua nuk duhet të kaloj në rend dite por duhet të shtyhet se nuk është në përputhje me rregulloren.

Kryetarja e Bashkisë: Një komitet i tillë ekziston. Është ngritur nga Këshilli Bashkiak e cila e ka vijë mësinë i cili në bazë të ligjit për pushtetin vendor me mbarimin e një palë zgjedhje një këshill që ka një mandat të përcaktuar ndiqet nga një këshill i një mandati tjetër dhe komitetet që ngre këshilli i mëparshëm janë në fuqi pa u shkarkuar nga këshilli që vjen më vonë. Komiteti ekziston dhe është mbledhur.

A.Salillari: Hdhjet në votim.

Miratohet rendi i ditës me 12 Vota pro, dhe 5 Vota kundër.

A.Salillari: Pika 2 e rendit të ditës: Miratimi i proces-verbalit të mbledhjes së kaluar.

A.Salillari: Hidhet në votim .

Miratohet me 17 Vota pro nga 17 këshilltarë prezeëntë.

Pika 3 e rendit të ditës: Miratimi i ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për 5 familje me fond prej 22.528 lekë për muajin Tetor sipas listës bashkëlidhur.

B.Mjelli: Kryetare e Komisionit Ekonomik Financë, për këtë pikë u mblodh Komisioni i Ekonomisë Financë dhe nuk kishte asnjë kundërshtim për këtë listë.

M.Tomani: Sektori i Ndihmës Ekonomike propozon për muajin Tetor 5 familje me fond i kushtëzuar 6% referuar nga sistemi me një fond prej 22.528 lekë.

A.Salillari: Hidhet në votim .

Miratohet me 17 Vota pro nga 17 Këshilltarë prezentë.

Pika 4 e rendit të ditës: “Trajtimi me ndihmë ekonomike sipas listës emërore bashkëlidhur për 101 familje nga Fondi i Bashkisë në shumën 252.000 lekë për muajin Tetor 2023.

B.Mjelli: Edhe për këtë pikë u mblodh komisioni i Ekonomisë Financë Buxhet e Tatim Taksa dhe nuk kishte asnjë kundërshtim, të gjithë ishin dakort për listën.

M.Tomani: Në mbështetje të ligjit nr. 9355 datë 10.03.2005 “ Për ndihmë dhe Shërbime Shoqërore” i ndryshuar, Sektori i ndihmës Ekonomike propozon për Muajin Tetor 2023 për trajtim me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë për 101 familje me një fond prej 252.000 lekë.

Familjet janë përzgjedhur nga administratorët dhe rekomanduar nga drejtori i NE-së duke u bazuar në kriteret e miratuara me Vendim Keshilli.

A.Salillari: Hidhet në Votim.

Miratohet me 17 Vota pro nga 17 Këshilltarë prezentë.

Pika 5 e rendit të ditës: “ Mbi miratimin e projekt-vendimit: Për shtesë Buxheti viti 2023.

B.Mjelli: Po dhe këtë pikë e kemi kaluar në komision.

Sh.Tafa: Po e kemi kaluar në komision por kemi pasur dhe vërejtjet tona.

Drejtorja e Ekonomisë dhe Financës: Mbështetur në aktin normativ nr 5datë 18.10.2023 “ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.84/2022 “Për buxhetine vitit 2023” si dhe shkresës së ardhur nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë nr 19139/1 datë 23.10.2023 protokolluar në Bashki me nr. Prot 56/17 datë 26.10.2023 BashkisëDimal i akordohet shtesë fondi transfertë e pakushtëzuar në strukturën buxhetore në masën 5.000.000 lekë.

Përdorimi i këtij fondi bëhet me miratim nga Këshilli Bashkiak. Propozojmë që ky fond të përdoret për shërbimin e pastrimit.

A.Salillari: Hidhet në votim.

Miratohet me 17 vota pro nga 17 Këshilltarë prezentë.

Pika 6 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit: “Mbi miratimin e ngritjes së Këshillit vendor për Siguri Publike”

P.Pilo: Këshilli Vendor për Siguri publike si një forum i përbërë nga të gjithë aktorët vendorë, institucionet publike, OJF-të grupet vendore të interesit dhe qytetarët i krijuar për të diskutuar për sigurinë publike në vend si dhe ër të rritur bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërmjet aktorëve dhe partnerëve të ndryshëm vendor për të zgjidhur ceshtjet e sigurisë vendore. Qëllimi i këshillit Vendor për siguri publike është të kontribuojë në rritjen e sigurisë publike si një organ këshillimor në Bashki.

Si dhe duhet të miratohet njëkohësisht edhe rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor për Siguri Publike.

L.Plaku: Është një ndër pikat e cila u shqyrtua dhe në komision dhe ishin të gjithë dakort pasi i shërben komunitetit tonë.

A.Salillari: Hidhet në votim.

Miratohet me 17 vota pro nga 17 Këshilltarë prezentë.

Pika 7 e rendit të ditës: Mbi miratimin e projekt-vendimit : Mbi miratimin e distancës në km të linjave të transportit për efekt të përlogaritjes së përfitimit të transportimit të punonjesve mësimorë që punojnë dhe të nxënësve jasht vendbanimit të tyre.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit: Bazuar në kërkesën nr. 876 prot datë 18.10.2023 nga Zyra Vendore Arsimore Dimal “ Për miratimin e linjave të transportit dhe distancave në km sipas VKM-ve përkatëse. Zyra Vendore Arsimore Dimal ka sjellë shkresë duke kërkuar miratimin e linjave të transportit dhe distancave në km.

Për këtë arsye kërkojmë konfirmimin dhe miratimin nga ana juaj të linjave sipas distancës në km për mësuesit dhe nxënësit që udhëtojnë nga vendbanimi i përhershëm për në vendin e punës të punonjesve mësimorë mbi 5 km dhe nga vendbanimi i përhershëm për në shkollë për nxënësit mbi 2 km sipas tabelës bashkëlidhur.

L.Plaku: Edhe kjo pikë e rendit të ditës ishte pjesë e komisionit e cila u diskutua për distancën në km. Nuk është se ka kosto bashkia është vetëm për miratimin e distancave në km.

A.Salillari: Hidhet në votim.

Miratohet me 17 vota pro nga 17 këshilltarë prezentë.

Pika 8 e rendit të ditës: Miratimin e dhënies së titullit të Lartë Vendor “ Qytetar Nderi” i Bashkisë Dimal.

R.Hoxha: Referuar kërkesës së sjellë nga Organizata e Veteranëve, bashkëlidhur gjeni CV e tyre përkatëse dhe mbi tavolinë gjeni CV e Z. Karafil Hamit Dhëmbo pasi mungonte në materialin e sjellë tek CV. Kërkojmë miratimin tuaj për dhënien e titujve të Lartë Vendor “QytetarNderi” i Bashkisë Dimal sipas listës së sjellë me motivacionin: Për kontributin që dha si luftëtar i lirisë, i angazhuar në formacionet partizane të LANC ë luftën e dytë botërore, Atdhetar, patriot i shquar që me trimërinë dhe heroizmin e dhënë në betejat luftarake kundër pushtuesve e bashkëpunëtorëve të tyre që i dha Shqipërisë, familjeve dhe brezave krenarinë për lirinë e fituar më 29 Nëntor 1944.

Sh.Tafa: A është protokolluar kjo kërkesë?

R.Hoxha: Po kërkesa është protokolluar në Bashki me nr 3698 prot datë 14.11.2023.

L.Goga: Edhe sa do të qëndroj ky komision?

Kryetarja e Bashkisë : Nëse ju nuk jeni dakort për komisionin, bëni propozime dhe na i sillni.

G.Hazizolli: Duam që ai komision të riformohet?

Kryetarja e Bashkisë: Dakort bëni propozime dhe na i sillni.Komisioni ekziston është i ngritur dhe është në fuqi, nëse këni propozime na i sillni.

K.Protoduari: Në mbledhjen e komisionit e kemi lënë për shqyrtim.

R.Hoxha: Në mbledhjen e komisionit të Arsim Kulturës kanë qënë të pranishëm 2 prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Figurës.

Sh.Tafa: Këta mund të ishin për certifikatë mirënjohje dhe jo për Qytetar Nderi.

Kryetarja e Bashkisë: Ky është mendimi juaj.

Sh.Tafa: Mund të ishte rasti i Axiem Oshafit për Qytetar Nderi.

Kryetarja e Bashkisë: Të gjithë jemi dakort që të bëjmë Qytetar Nderi Axiem Oshafin pas vdekjes , nuk kemi asnjë kundërshtim njeri punëtor në krye të detyrës.

H.Hoxha: Të gjithë në si anëtar këshilli kemi të drejtën për propozime ka një sekretare këshilli dorëzoi asaj dhe ia përcakton zyrave përkatëse.

A.Salillari: Hidhet në votim.

Miratohet me 13 vota pro, 3 vota kundër, 1 Abstenim nga 17 këshilltarë prezentë.

Pika 9 e rendit të ditës: Për disa shtesa dhe ndryshime në pakeetën fiskale VKB Nr.72 datë 21.11.202”

K.Protoduari: Një pyetje për Kryetaren e Komisionit Ekonomisë a ka kaluar si pikë në mbledhjen e Komisionit.

B.Mjelli: Po si pikë në total ka kaluar me vërejtet e veta.

Sh.Tafa: Të na jepet e plotëpaketa fiskale të gjithë anëtarëve të këshillit.

Kryetarja e Bashkisë: Paketa fiskale është transparente në ëeb site e Ministrisë së Financave dhe që e publikon në mënyrë të vazhdueshme.

Sh.Tafa: Këto ndryshime sa e ul nivelin e të ardhurave të paarkëtuara?

I.Shehu: Një vlerë e papërfillshme.

I.shehu: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave të parashikuara për periudhën 1 Janar 2023- 31 djetoj si më poshtë: Tregues të performancës vjetore.

1. Parashikimi për vitin 2023 është 257.881.000 lekë.

2. parashikimi i realizimit 2023 parashikohet të jetë 173.000.000 lekë ose 67%.

Të ardhurat e veta që mblidhen nga Administrata e Bashkisë në vitet 2024-2026 parashikohen që të kenë një trend të njëjtë për tre vitet e ardhshme.

Kategoritë e Taksave dhe tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave nga burimet e veta për vitet 2024-2026 janë kryesisht taksa e pasurisë së paluajtshme. Në përditësimin e paketës fiskale të Bashkisë Dimal ndër vite, janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh e të vogël, banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit dhe përfaqësues të partive politike e keshilltarë.

A.Salillari: Hidhet në votim.

Miratohet me 14 Vota pro, 2 kundër, 1 abstenim nga 17 këshilltarë prezentë.

Pika 10 e rendit të ditës: “Miratimin e zëvendësimit e anëtarit të Komisionit të Strehimit”.

L.Plaku: Edhe kjo pikë u diskutua në komisionin që u mbledh dhe të gjithë ishin dakort nuk kishin asnjë kundërshtim, ky material që ka ardhur nga Drejtoria e Planifikimit është për evitimin e problematikave në punë, për vijëmsinë e punës.

Drejtoria e Planifikimit të Territorit: Në mbështetje të nenit 24 të ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe nenit 68 të ligjit nr 22/2018 “ Për Strehimin Social”.

Për hartimin e programit 5 vjecar të strehimit bazë është ligji nr 22/2018 “ për Strehimin Social” i cili parashikon në mënyrë specifike instrumentat institucional dhe financiar për trajtimin e problemit të strehimit nga Bashkitë.

Për funksionimin e këtij programi dhe evitimin e problematikave në punë, lind nevoja për zëvendësimin e njëra prej anëtarëve të Komisionit të Strehimit.

Znj.Gerala Hoxha antar i Komisionit të Strehimit, ushtronte detyrat funksionale pranë institucionit tonë si specialist jurist. Për shkak të largimit nga puna/detyra propozojmë zëvendësimin e saj me Znj. Marsela Kumrija, aktualisht ushtron funksionin si specialist jurist pranë institucionit tonë.

A.Salillari: Hidhet në votim.

Miratohet me 17 Vota pro, dhe 1 Abstenim nga 17 Këshilltarë prezentë.

Pika 11 e rendit të ditës: “Të ndryshme”

L.Plaku: Kam një propozim për ndihmë ekonomike emergjente për familjen e zotit Fatos Cobo duke qënë se bashkëshortja e tij është shumë e rëndë e paralizuar në shtratë prej 3 vitesh e gjysëm. Zonja ka nevojë për shërbim dhe mjekime të cilat janë shumë të shtrenjta dhe gjendja financiare e familjes është shumë e vështirë dhe e pamundur për ti përballuar, familja e Fatos Cobo ndodhet në lagjen 18 Tetori dhe mendojmë në masën 100.000 lekë.

A.Salillari : Hidhet në votim.

Miratohet me 17 Vota pro nga 17 Keshilltare prezentë.

F.Plaku: Ka ardhur një kërkesë drejtuar Këshillit Bashkiak Dimal. Z. Bilal Toska ka paraqitur një kërkesë për hapjen e rrugës me Nr. Pasurie 55/12. Zotëria si cdo fermer tjetër ka të drejtë të kërkoj rrugë kalimi më të shkurtër, kur rruga e tij ekzistuese është shumë e gjatë për të shkuar te parcela e tij, por nga ana jonë është e pamundur për t’ia mundësuar hapjen e rrugës.

Dha bashkia si institucion nuk ka të drejtë të trajtoj një servitut kalimi ndaj duhet ti drejtohet gjykatës për këtë problem si organ kompetent ligjor për ti dhënë zgjidhje.

Sh.Tafa: Kam një shqetësim për një rrugë ullishteje në fshatin Gorican.

Kryetarja e Bashkisë: Po ke të drejtë për atë pjesë rruge dhe do ta shikojmë do ta kemi në konsideratë.

